



www.lezha.gov.al

bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, Nr. 9, prill 2018



Përkujtohet 574 vjetori i Besëlidhjes së Lezhës



Festimi i Pashkëve në Lezhë, fq. 16




Erozioni po gërryen bregdetin, fq 12



Përurohet qendra e shëndetit CASA OLA, fq 8




Lezha në Vitin e Skënderbeu fq 20



Redaksia

Drejtoria e Integritimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri
Fotot: Olsi Tetaj
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al



Përkujtohet 574 vjetori i Besëlidhjes së Lezhës	4
Mesazhe paqeje në rrugët e Lezhës	6
Frokokaj pret një delegacion polak nga Rrethi Nysa	7
CASA Ola - qendra e shëndetit të gruas dhe fëmijës	8
Prezantohet projekti për PAK	11
Erozioni po gërryen bregdetin e Shëngjinit	12
Përpjekje për të parandaluar përmytjet	13
Dita e Verës në kalanë e Lezhës	14
Lule për gratë e FPM nga bashkia Lezhë	15
FESTIMI I PASHKËVE NË LEZHË	16
Aktivitete në kuadrin e Ditës së Romëve	18
Lezha në Vitin e Gjergj Kastriotit -Skënderbeu	20
At Sirdani në Ditën Ndërkombëtare të Librit	21

PËRKUJTOHET 574 VJETORI I BESËLIDHJES SË LEZHËS

Në përkujtim të 574-vjetorit të Kuvendit të Lezhës, një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar, Bashkia e Lezhës ka organizuar veprimtari kulturore artistike me temë: “Rron në shekuj Besëlidhja e Lezhës”. Në këtë përvjetor të Kuvendit Historik, që përkon me Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skenderbeut, ishin të pranishëm kreu i Bashkisë Lezhë, z.Fran Frrokaj, Presidenti i Republikës z. Ilir Meta, Ministri e Arsimit, Lindita Nikolla, deputetë, drejtues të pushtetit lokal, besimeve fetare, qytetarë, nxënës shkollash, përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, historianë, studiues dhe akademikë nga Shqipëria dhe trojet shqiptare.

Tek Memoriali i Gjergj Kastriotit - Skenderbeut, nën tingujt e Hymnit Kombëtar, Presidenti Meta, kreu i Bashkisë Lezhë Frrokaj dhe përfaqësues të Qeverisë Shqiptare dhe të Kosovës vendosën kurora me lule.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kreu i Bashkisë z.Fran Frrokaj u shpreh: -“Lezha përkujton një datë historike që ruhet në memorien e të gjithë shqiptarëve si një trashëgimi e vyer e trimërisë dhe urtësisë së Gjergj Kastriotit, njeriut simbol të bashkimit të kombit që u bë baza e themelit të shtetit. Ndaj ne jemi krenarë që identifikohemi me prijësin dhe përbashkuesin e Kuvendit të Lezhës, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, këtë kalorës legjendar që për 25-vjet mbrojti atdheun e tij dhe u bë mburojë e qytetërimit evropian. Me krenarinë që i përkasim këtij qyteti, i cili 574 vjet më parë pati nderin të mirëpresë dhe të shënojë Besëlidhjen e parë të shqiptarëve në histori, të punojmë për ta ruajtur këtë qytet si simbol të bashkimit, unitetit, harmonisë dhe mirëkuptimit njerëzor”-, përfundoi fjalën e tij Frrokaj.

Ndërsa Ministri e Arsimit, Lindita Nikolla, thek-



soi se Besëlidhja e Lezhës është një moment i rëndësishëm reflektimi për të gjithë ne, për të punuar fort në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave të bashkimit, patriotizmit dhe dashurisë së madhe për Shqipërinë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti Meta tha se Lezha është një qytet dy herë me fat, e bekuar nga Zoti dhe Skënderbeu. Ai e vlerësoi 2-Marsin si ditë të shenjtë për të gjithë shqiptarët pasi kjo datë na obligon të kujtojmë veprën më të madhe që bëri heroji ynë kombëtar, bashkimin e shqiptarëve. Kuvendi historik i Lezhës shënon përmbylljen e një prej periudhave më të shndritshme të historisë sonë, kur shqipëria nën udhëheqjen e Skënderbeut, iu imponua europës si

mbrojtëse e qytetërimit dhe civilizimit të saj.

Ndërkohë, përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës, zëvendësministri i jashtëm Gjergj Dedaj, duke e vlerësuar Kuvendin e Lezhës si një nga datat më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar, evidentoi faktin se mesazhet e Besëlidhjes së vitit 1444 kanë vlerë aktuale për të gjithë ne, si në Shqipëri dhe në Kosovë. Kjo Besëlidhje meriton të riaktualizohet që të jemi bashkë Shqipëri e Kosovë në integrimet europiane. Asgjë nuk e ndal bashkimin e jetës tone të përbashkët. Në emër të kryetarit të opozitës Lulzim Basha përshëndeti dhe sekretari i përgjithshëm i PD-së Arben Ristani. Në mjediset e Memorialit të Skënderbeut kryebashkiaku Frrokaj i dhuroi Presidentit Meta albumin e Skënderbeut.



Më pas në sallën e pallatit të kulturës nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Besëlidhja” në bashkëpunim me grupet artistike të bashkisë Lezhë, dhanë një program artistik me këngë kushtuar Skënderbeut dhe Kuvendit të Lezhës. Erdhi për të përshëndetur me një këngë kushtuar Besëlidhjes së Lezhës dhe grupi polifonik i Mallakstrës.



Mesazhe paqeje në rrugët dhe sheshet e qytetit të Lezhës

Këto ditë të bukura pranvere gjallërojnë më shumë nga buzëqeshjet e fëmijëve. Bashkë me nxënës dhe mësues të shkollës Besëlidhja ishin punonjësit e administratës, zv.kryetarja e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku dhe drejtues të drejtorive, të cilët dhuruan momente gëzimi duke shpërndarë nëpër rrugët e qytetit 1000 mesazhe paqeje dhe dashurie si: “Buzëqeshja është një fjalë e bukur pa shkronja , ndaj dhuroje atë; Buzëqeshja një ilaç shumë i dobishëm; Nuk do ta ndërroja kurrë buzëqeshjen e zemrës sime as me të gjitha pasuritë e botës; Në fund të ditës mbaj në kujtesë vetëm gjërat pozitive të saj; Buzëqesh;” etj.

Paqja fillon me një buzëqeshje – shprehej E Shenjta Nënë Terezë.



Frrokaj pret një delegacion polak nga Rrethi Nysa

Në festimet e 574 vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës , mori pjesë edhe një delegacion i Rrethit Nysa dhe Komunës Otmuchov me ftesë të kreut të Bashkisë Lezhë, z FRAN FRROKAJ. Delegacioni nga Polonia kryesohet nga kryetari i Qarkut Nysa, Czesllav Bilobran dhe nga kryetari i komunës Otmuchov, Jan Vozniak dhe përfaqësues të tjerë të katër entiteteve.

Z. Frrokaj në pritjen zyrtare për nder të delegacionit polak, rikonfirmoi vullnetin e institucionit që drejton për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Rrethin dhe Bashkinë Nysa dhe komunën Otmuchov dhe këmbënguli që aplikimi i projekteve të përbashkëta në fondet e BE mbetet një prioritet, sidomos ato në fushën e turizmit, për shtimin e turistëve polakë që do të vizitojnë bregdetin e Shëngjinit dhe Tales.

Gjatw pritjes nw Zyrwn e Kryeatrit tw Bashkisw, u dhurua nga zjarrfikwsit e Otmuchovit njw pompw me fuqi mesatare pwr zjarrfikwsit e Lezhws dhe u vendoswn ura bashkwpunimi mes dy sektorwve. Z.Czesllav Bilobran dhe Z. Jan Vosniak duke shprehur kënaqësinë e pjesëmarrjes në këto aktivitete festive, konfirmuan dhe mundësitë konkrete për bashkëpunimin në të ardhmen e konkretisht:



- Trajnimin e 3 specialistëve të bashkisë Lezhë për njohjen me praktikën e mira për hartimin dhe aplikimin në fondet e BE .

- Ndhimën në trajnimin dhe sigurimin e paisjeve për sektorin e zjarrfikësve.

- Prezantimin e produkteve tradicionale vendore, polake dhe shqiptare, në Nysa - Poloni dhe botimi i përbashkët i një katalogu për këtë qëllim .

- Marrja pjesë në festimet e rrethit Nysa e një grupi folklorik nga Lezha si dhe një grupi prej 30 fëmijësh të shkollave 9-vjeçare të Lezhës në kampin veror, prej 30 ditësh, që organizohet çdo vit me fëmijët e rajoneve partnere të rrethit Nysa , nga shtete si Gjermania, Italia dhe Ukrahina.

- Aplikimi në dy projekte të përbashkëta, mes palëve, në fushën e bashkëpunimit mes qytetarëve të disa vendeve të BE (Gjermani, Portugali, Poloni dhe Shqipëri) si dhe organizimi i një FORUMI për zhvillimin e turizmit dhe një takimi B2B mes operatorëve turistike të dy vendeve për të promovuar dhe nxitur shkëmbimet turistike .



Përrurohet në Lezhë qendra e shëndetit të gruas dhe fëmijës

Përrurohet në Lezhë qendra e shëndetit të gruas dhe fëmijës

Banorët e Bashkisë Lezhë, kanë përfituar një shërbim mjaft të domosdoshëm për shëndetin e gruas dhe fëmijës, kjo falë inagurimit të qendres “Casa Ola”, një ndër investimet më të rëndësishme të realizuara së fundmi. Ky projekt është realizuar nga financimi i Operae Life Onlus me presidente Znj. Laura Bellamoli dhe Bashkisë Lezhë si dhe me mbështetjen e Rajonit të Trentino-Alto Adige, Itali. Kjo është një vepër dedikuar kujdesit të shëndetit të gruas dhe fëmijës në Rajonin e Lezhës.

Qendra do të jetë në shërbim të qytetarëve të Lezhës dhe kryesisht shtresave në nevojë që do të gjejnë këtu një pikë të sigurtë diagnostikimi për problemet me shëndetin.

Në ceremoninë e përrurimit morën pjesë: Ambasadori i Italisë, z. Alberto Cutillo, zv.Ministrja e Shëndetësisë, znj.Mira Rakacolli, përfaqësues të Rajonit Trentino Alto-Adige, donatorë, mjekë e autoritete lokale. Kryetari i Bashkisë z.Fran Frrokaj, pasi vlerësoi bashkëpunimin për ngritjen e kësaj qëndre, nënvizoi rëndësinë e një bashkëpunimi të mëtejshëm në rritjen e cilësisë së shërbimit mjeksor ndaj komunitetit qytetar.

“Në emrin e Bashkisë Lezhë dhe emrin tim, ju falenderoj për kontributin që keni dhënë në real-



Casa OLA, një shembull konkret i punës me partnerët

izimin e CASA OLA, një qendër multifunkionale e shëndetit të Gruas dhe Fëmijës, e cila është ndër projektet me të rëndësishme që Bashkia Lezhë ka realizuar vitet e fundit. Kjo qendër me vlerë rreth 500 mijë Euro, do të shërbejë si qendër diagnostikuese dhe ekzaminuese për gruan dhe fëmijët. Qendra Casa OLA ka një sipërfaqje prej 506 m2 e cila do të konsistojë në: përmirësimin e stilit të jetës, zhvillimin e formave të parandalimit, zhvillimin e vetëdijësim-it të rolit të gruas në familje si motor i rëndësishëm i ndryshimit të mënyrës së jetesës. Në këtë qendër do të realizohen një sërë shërbimesh shëndetësore si: nevojat për fizioterapist, stomatolog, neoropsikiater, pediatër, psikomotorrist, okulist, gjinokolog, onkolog dhe obsetrikë. Dua të falenderoj Opera Life dhe të gjithë donatorët si dhe të shpreh bindjen se bashkëpunimi i Bashkisë së Lezhës do vazhdojë të jetë i sukseshëm deri në implementimin e plotë të shërbimeve shëndetësore në qendren OLA”, nënvizoi z.Frrokaj.

Kryetari i Bashkisë Lezhë Z.Fran Frrokaj së bashku me Kryetarin e Këshillit Bashkiak z.Kristjan Gjiodaj, i dorëzuan titullin “Qytetar Nderi” znj.Laura Bellamoli, Presidente e Operae Life dhe Moter Giovana Maria Alessio, që ndihmuan në ngritjen dhe financimin e kësaj qëndre kaq të rëndësishme në shërbimin shëndetësor ndaj komunitetit të Bashkisë Lezhë.



Administrata e Bashkisë Lezhë dhuron gjak për fëmijët talasemik

Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar Dega Lezhë kanë organizuar në mjediset e pallatit të kulturës aktivitetin human të dhurimit vullnetar të gjakut. Janë solidarizuar me këtë nismë stafet e drejtorive të Bashkisë dhe Njësive Administrative. Zëdhënësi i Bashkisë Lezhë Altin Mema shprehet se askush nuk është bërë i varfër duke dhuruar. Ky gjest humanizmi do t'ju vijë në ndihmë të sëmurëve në nevojë dhe mund të krijojë mijëra buzëqeshje. Administratorja e degës së Kryqit të Kuq Lezhë, Irma Kola, thekson se kush dhuron gjak shpëton një jetë. Janë mbi 1000 fëmijë të sëmurë talasemikë që presin ndihmë nga dhuruesit e gjakut.

Me gadishmërinë për t'ju përgjigjur thirrjes se Kryqit të Kuq, krahas administratës dhe punonjësve të Bashkisë Lezhë janë solidarizuar dhe qytetarë të Lezhës. Ky dhurim gjaku, veç fëmijëve talasemikë do të shkojë dhe për nevojat e pacientëve të Spitalit Rajonal të Lezhës.



Takime sensibilizuese për mbrojtjen e fëmijëve

Sektor i Kujdesit Social pranë Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Eorld Vision po organizon takime informuese dhe ndërgjegjësuere mbi rolin, përgjegjësitë dhe funksionin që ka ky sektor, që lidhet me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve ashtu edhe problemet e dhunës në familje.

Takimet ndërgjegjësuere kanë filluar të zhvillohen në të gjitha shkollat e Lezhës dhe gjithashtu me anëtarë të komunitetit, gra dhe burra.

Krahas njohjes së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve janë diskutuar tema shumë të rëndësishme si “Mbrojtja e fëmijëve nga interneti i pasigurt”, “Fenomeni i bullizmit” dhe probleme të tjera që shqetësojnë fëmijët sot.

Aktualisht janë zhvilluar takime në shkollat: “Karl Gega” Balldre, “Rogacionistet” Lezhë, shkolla 9 - vjeçare Kolajakaj, gjimnazi Torovicë, shkolla 9-vjeçare Rraboshtë dhe do të vijojnë takime të tilla në të gjitha shkollat e Lezhës.



World Vision ka prezantuar në Bashkinë e Lezhës projektin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Është prezantuar në Bashkinë e Lezhës projekti “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi ndryshe në Shqipëri”. Ky projekt do të financohet nga Bashkimi Europian dhe do të zbatohet në disa bashki, përfshirë dhe Bashkinë Lezhë, nga organizata World Vision në partneritet me organizatën Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK) dhe Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF).

Gjatë takimit, zv.kryetarja e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku, vlerësoi rëndësinë e këtij projekti si dhe kërkoi vëmendjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi detyrimin për të bërë transparente kriteret e pikëzimit në skemën e re të ndihmës ekonomike si dhe detyrimin për të trajtuar në mënyrë të barabartë përpara ligjit të gjithë qytetarët. Ndër 1004 familjet e përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike, vijoi Marku, në Bashkinë Lezhë, rreth 100 familje kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi ndryshe si dhe jetojnë në një realitet tejet të vështirë ekonomik dhe social. Ndërkohë në sheshin para bashkisë Lezhë ishin ekspozuar 18 foto, të gjitha bardh e zi, që flasin për 12 jetë si një udhëtim drejt dhimbjes. Këta 12 fëmijë me aftësi të kufizuara janë dëshmitarë të përballjes së indiferencës me solidaritetin, të dashurisë me dhimbjen, të luftës mes të mundurës dhe të pamundurës. Secili prej këtyre fëmijëve që jeton në zonat e thella të vendit aty ku ka zënë vend harresa, varfëria, mungesa e rrugëve dhe shërbimeve, përballet çdo ditë me pamundësinë për të jetuar fëmijërinë. Në foto duket qartë se e gjithë familja vuan bashkë me ta, në heshtje, në vetmi. Ata presin me shpresën se e nesërmja do të jetë më e mirë!



Erozioni po gërryen rërën e plazheve dhe brezin e gjelbërt të bregdetit të Shëngjinit

Erozioni, duke gërryer rërën e plazhit dhe brezin e gjelbërt, ka krijuar një situatë alarmante në bregdetin e Shëngjinit. Pishat me moshë 50-vjeçare dhe bimësia e bregut po shkojnë në det, duke u rrezikuar dhe laguna e Kunes aty pranë.

Shqetësimi i Bashkisë Lezhë dhe ekspertëve të mjedisit për këtë që po ndodh në zonën e Kune-Vainit, mbetet evident. Ambientalisti Jak Gjini, situatën e krijuar e vlerëson si mjaft shqetësuese dhe mendon se amortizimi i saj dikton nevojën e ndërtimit të dallgëthyeseve dhe rehabilitimit të dunave.

Tre dekadat e fundit, vija bregdetare e Kune-Vainit është përballur me një erozion agresiv të detit i cili po avancohet me shpejtësi, duke e tjetërsuar mjedisin ligatinor me vlera të pazevëndësueshme për biodiversitetin. Si pasojë e këtij fenomeni, që nga vitet 70-të është asgjësuar 362 ha e kësaj zone bregdetare të Shëngjinit.

Në të tilla kushte emergjente, Bashkia Lezhë përmes shkresave zyrtare i bën thirrje Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për marrjen e masave të menjëhershme për frenimin e këtij fenomeni nëpërmjet ndërhyrjeve me projekte urgjente të specializuara dhe që janë kompetencë e tyre.



Përprojekte të vazhdueshme për të parandaluar përmbytjet

Bashkia e Lezhës, me mjetet dhe mundësitë që disponon, ka punuar gjatw gjithw dimrit me intensitet për pastrimin e kanaleve të dyta e të treta kulluese. Ndonëse në kushtet e një terreni me borë dhe ngrica, puna u përqëndrua në zonat më problematike si: në fushën e Torovicës, Njësia Administrative Balldre; në Tresh-Spiten, Njësia Administrative Zejmen; në sipërfaqet e Njesisë Administrative Shënkoll, për të vijuar pastaj edhe në njësitet e tjera. Fermerët me tokë bujqësore në këto zona, gjithnjë kanë qenë të ekspozuar ndaj fenomenit përmbytje. Të mbjellat e tyre prej vitesh janë përmbytur dhe këtë punë që po bën Bashkia Lezhë, e vlerësojnë si mjaft cilësore dhe të domosdoshme në parandalimin e përmbytjeve të tokave të tyre bujqësore.

Për drejtorin e drejtorisë së bujqësisë, pyjeve dhe zhvillimit rural, Gjovalin Gjeloshi, nevoja për këtë ndërhyrje ka qenë tepër emergjente pasi nga bllokimi i kana-

leve përmbytjet kanë qenë të vazhdueshme, dhe prej shumë vitesh fermerët mbjellin por nuk korrin. Në gjithë sipërfaqet bujqësore të Lezhës, deri më tani janë pastruar e thelluar mbi 120 km kanale të para e të dyta kulluese dhe janë lëvizur mbi 300 mijë m³ dhera, duke rehabilituar rrjetin kullues në një sipërfaqe prej mëse 4000 mijë ha. Gjeloshi evidenton edhe bashkëpunimin me bordin e kullimit Lezhë, i cili po ndihmon me eskavatorë në pastrimin dhe thellimin e kanaleve të dyta kulluese. Krahas njësive të tjera, me intensitet po punohet në Njësine Administrative Balldre ku deri më tani janë pastruar e thelluar 60 km kanale kulluese. Në këtë njësi fenomeni i përmbytjeve të të mbjellave gradualisht po shkon drejt parandalimit.

Puna që po bën Bashkia për kullimin e fushave të Lezhës është investimi më i dobishëm që shpëton një herë e mirë nga përmbytjet tokat bujqësore dhe të mbjellat e fermerëve.



Dita e Verës në kalanë e Lezhës

Për komunitetin e Lezhës destinacioni kryesor i festimeve në Ditën e Verës ka qënë kalaja e qytetit. Të rinj e të reja, nxënës shkollash e qytetarë preferuan të udhëtonin në këmbë deri në mjediset e kalasë, ku Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër dhe Sofrën Shqiptare kishin marrë të gjitha masat për festimin në mënyrë sa më argëtuese të kësaj dite.

Tingujt dhe ritmet muzikore shoqëroheshin me këngë, valle, lojra popullore dhe ato me top. Ndërkohë biznesi vendas kishte ngritur pika të ndryshme ambulatore që ofronte për festuesit artikuj të ndryshëm ushqimor dhe një kuzhinë tradicionale. Të favorizuar nga koha e mire, festuesit kishin lënë në garderobat e tyre veshjen e dimrit për t'i zëvendësuar me ato të pranverës.

Kreu i Bashkisë së Lezhës Fran Frrokaj, i pranishëm në këto festime, e cilësoi këtë ditë si një ditë të vërtetë vere. Ai me këtë rast i shprehu urimet më të mira gjithë komunitetin lezhjan, duke ju uruar një jetë më cilësore dhe me sa më pak probleme.

Drejtori i Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit pranë Bashkisë Lezhë Ardian Laçi nënvizon faktin se në festimet e kësaj dite zgjodhëm objektin e kalasë për qellimin argëtues të komunitetit si dhe për të njohur e promovuar vlerat historike që mbart ky aset i çmuar i kulturës sonë.

Në mjediset e kalasë së Lezhës, aktivitetet kulturore, artistike e sportive, të organizuara nga Bashkia e Lezhës, në Ditën e Verës, vijuan deri në orët e pasditës.



Lule për gratë e FPNM-së nga Bashkia

Në 8-Mars Bashkia Lezhë dhuron lule për më shumë se 100 gra dhe vajza punonjëse në Fabrikën e Përpunimit të Nënprodukteve të Mishit. Janë punonjëset e drejtorisë së shërbimit social dhe zëvendëskryetarja e bashkisë Alfrida Marku, që kanë përgatitur e dhuruar lule enkas për këto gra e vajza në këtë ditë të festës së tyre. Kudo në mjediset e kësaj fabrike u krijua një atmosferë feste e gëzimi që shoqërohej me buzëqeshje, mirënjohje dhe respekt të dyanshëm. Çdo lule e dhuruar mbante shkrimin: "Bashkia Lezhë ju uron gëzuar 8-Marsin, ju nënave, motrave, vajzave, që çdo ditë i jepni kuptim jetës".

Në fjalën e saj përshëndetëse, zëvendëskryetarja e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku u shpreh se, këtë 8-Mars vendosëm të festojmë së bashku me ju gratë dhe vajzat e kësaj fabrike, që në emër të familjeve dhe mirëqenies tuaj pranoni të bëni dhe punë të vështira. Ne të gjithë duhet të reflektojmë, vijoi Marku, në kurimin dhe zgjidhjen e problemeve që ka shoqëria jonë sot. Respekti ndaj jush, nënave dhe motrave tona, është çelësi i zgjidhjes së këtyre problemeve të cilat nisin tek barazia në familje, kushtet e mira të punës, mosdiskriminimi, eliminimi i dhunës në familje, shmangia e martesave të hershme dhe bërja e maksimumit për arsimimin e grave dhe vajzave. Të gjitha këto mbeten pikat kyçe që shëndoshin shoqërinë tonë. Lule, çokollata dhe një bashkëbisedim i përzemërt me gjithë gratë dhe vajzat e kësaj fabrike, që punojnë për rritjen e mirëqenies së familjeve të tyre. Në fund, një foto e perbashkët me gratë e vajzat e drejtorisë së shërbimit social pranë Bashkisë Lezhë, si shenjë e respektit, vlerësimit dhe dashurisë së ndërsjellë.

FESTIMI I PASHKËVE NË LEZHË

Besimtarët katolikë të Lezhës kanë kremtuar Ditën e Pashkëve, ngjalljen e Krishtit, si dita më e rëndësishme në kalendarin festiv të krishterë. Janë fëmijët e Qendrës Kulturore “Gjergj Laca” të cilët duke zënë vend para Katedrales së Shën Nikollës dhe pranë busit të Papa Gjon Palit të dytë kanë pritur besimtarët katolikë, kalimtarë të shumtë në rrugë dhe qytetarë të Lezhës duke u servitur atyre vezë të kuqe dhe pije me lëngje frutash të përgatitura me dashuri dhe kujdes nga lokalet “Mrizi i Zanave” dhe “Stela”. Drejtori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, Marçel Laca, një ndër gjeneratorët kryesor të kësaj ditë-feste, me entuziazëm e dashuri citon vargjet e poetit tonë kombëtar At Gjergj Fishta: “Kemi Bajram e kemi Pashkë dhe Shqipërinë e kemi bashkë”

E veçanta e festimit të Pashkëve këtë vit ishte një karrocë e vogël shëtitëse e ngarkuar me vezë dhe ushqime të tjera tradicionale, simbolikë kjo e viteve kur është ringjallur Jezu Krishti. Pronari i Mrizit të Zanave, Altin Prenga, e ka përgatitur enkas për këtë ditë, si dhuratë për bashkëqytetarët e tij. Lirim Torba, pronari i lokalit “Stela”, është treguar mjaft bujar në këtë ditë të Pashkëve me fëmijët e qytetit dhe vëllezërit e besimit katolik. Një Pashkë ndryshe në sheshin më katolik të Shqipërisë. Risinë e sollën në Lezhë tek “Papa Gjon Pali i Dytë” një katolik dhe një mysliman. Ata janë të dy biznesmenë por i ka bashkuar festa dhe dëshira për t'i bërë bashkë lezhanët pavarësisht besimeve fetare. Altin Prenga e Lirim Torba mundësuan për çdo vizitor vezë dhe ushqime të tjera që na kujtojnë ringjalljen e Krishtit. Për Altin Prengën kjo mënyrë të festuari është thjesht



Gezuar Pashkët!

ripërtëritje e një tradite që ka ekzistuar, ndërsa Lirim Torba i besimit musliman thotë se festat nuk kanë përkatësi fetare. Në mbështetje të këtij aktiviteti ishte dhe Bashkia Lezhë. Artistët e qendrës kulturore të fëmijëve krijuan një atmosferë të gëzueshme. Përcollim urimin për festën e Pashkëve edhe nënkryetarja e Bashkisë Lezhë, Alfrida Marku. Kjo mënyrë e të festuarit prej një viti është kthyer në traditë për Lezhën, duke dhënë në këtë mënyrë shembullin e harmonisë fetare që mbizotëron në këtë rajon.

Të gjithë besimtarët shkëmbyen urime me njëri-tjetrin për këtë ditë, duke u lutur për më shumë besim, dashuri, paqe, begati dhe lumturi.

Më pas në Katedralën e Shën Nikollës u celebrua mesha e shenjtë. Aty u tha para besimtarëve të shumtë që duhet besim i madh në Zotin Jezu Krisht, reflektim për të dhuruar sa më shumë dashuri për njëri-tjetrin. Dita e Pashkëve si ditë e shenjtë e ringjalljes së Krishtit, si ditë e ringjalljes së shpirtit njerëzor dhe besimit tek Zoti, qoftë e lumtur për të gjithë! Flaka e ndezur simbolizon Ringjalljen e Krishtit pas sakrificimit të tij në kryq, moment ky që simbolizon rilindjen e shpresës, forcimin e besimit tek Zoti për të gjithë besimtarët, kalimin nga e përkohshmja në të përjetshmen dhe çlirimin e njerëzve nga mëkati.

Me shëndet Pashkët!

Në këtë mënyrë, Bashkia Lezhë përcjell urimet më të sinqerta në festën e Ringjalljes së Krishtit, festës së shpresës, besimit, sakrificës dhe triumfit mbi të keqen.

Aktivitete në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve

Në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve po implementohet në Lezhë projekti “Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”. Ky projekt zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe financohet nga Bashkimi European. Është Shoqata e Integritit të Romëve të Veriut që i ka dhënë jetë këtij projekti edhe për familjet e komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë në Lezhë.

Në këtë kuadër, duke patur dhe mbështetjen e Bashkisë Lezhë, po organizohen një sërë aktivitete që synojnë barazinë sociale, arsimimin dhe integrimin e këtyre komuniteteve. Hapja e ekspozitës me punimet e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian ka qënë njëri prej këtyre aktiviteteve. Në galerinë e arteve figurative të pallatit të kulturës ishin ekspozuar punimet më të mira që kishin si temë kryesore paqen. Skulptori Ymer Metalia evidentoi talentin e këtyre fëmijëve që shfaqet në pikturat e paraqitura. Drejtori i Arsimit, Turizmit e Kulturës pranë Bashkisë Lezhë, z.Ardian Laçi, në emër të kryetarit Fran Frrokaj, falenderoi fëmijët për punët e realizuara dhe premtoi mbështetjen e institucionit në inkurajimin e këtyre talenteve. Kryetari i shoqatës “Integrimi i Romëve të Veriut” Man Sinani, shprehu mirënjohje ndaj gjithë atyre që mendojnë e financojnë me projekte integruese për këto komunitete. Në fund, për fëmijët që kishin realizuar punimet më të mira u dhanë dhe çmime. Aktivitetet në Lezhë po vijojnë gjatë gjithë këtyre ditëve, të emërtuara si java e komunitetit rom dhe egjiptian.



Aktivitete argëtuese me fëmijet e QZHD “Trëndafilat”

Bashkia Lezhë, përmes aktiviteteve të shumëllojshme kujdeset për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjëve të Qëndres së Zhvillimit Ditor “Trëndafilat”. Sektori i Kujdesit Social në Bashkinë Lezhë bashkë me punonjës social të Qendrës Komunitare Multifunkionale, organizuan në bregdet një sërë aktivitete argëtuese për ta. Lojërat zbavitëse, ato me top dhe ushtrimet regjeneruese ishin praktikatat e kësaj dite. Një ditë e bukur, ku më shumë se dielli rrezatonin buzëqeshjet e këtyre fëmijëve. Bashkë, ne mund të plotësojmë njëri tjetrin.



leftës

Lezha në Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit -Skënderbeu

Në vitin mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut Lezha e Besëlidhjes historike dhe memoriali i heroit tonë kombëtar presin e përcjellin vizitorë të shumtë që vijnë nga mbarë trojet shqiptare. Këtë herë është shoqata Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", që ka zhvilluar manifestimin tradicional "Zëri Vëllazërisë 2018". Fillimisht të pranishmit bënë homazhe e vendosën tufa e kurora me lule pranë vendvarimit të heroit. Më pas, zv.kryetarja e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku, përfaqësues të shoqatave dhe përgjegjës të të sektorit të trashëgimisë kulturore, në fjalën e tyre ngritën lart figurën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, njeriut simbol të bashkimit të kombit që diti të arrijë konsensusin e princave hatërmbetës, duke u bërë baza e themelit të shtetit. Mbetet dëshmi e pakontestueshme, vijuan folësit, lidhja historike e Gjergj Kastriotit me Lezhën dhe Besëlidhjen e saj. Si luftëtar i lirisë, diplomat, burrë i madh shteti dhe mit i pavdekshëm në memorien e të gjithë shqiptarëve, Skënderbeu mbetet epokal. Koncerti artistik i shoqatës Kosovë-Malësi e Madhe

hapi siparin me vallen e shpatave. Në këtë manifestim morën pjesë edhe ansambli "Rugova" i Pejës, grupe kulturore artistike nga drenica e Istogu dhe shoqata atdhetare "Dukagjini". Ky rrugëtim historiko-artistik nisi në Lezhën e Gjergj Kastriotit për të vazhduar drejt Hosit dhe Tuzit e pikërisht në Deçiq tek kulla e Ded gjon Lulit, për të përfunduar në Prekaz tek kulla e Adem Jasharit.




Në vitin mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut Bashkia e Lezhës mirëpriti të shtunën, datë 21 prill, drejtues të Kishës Katolike të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë shoqëruar nga vëllezër të besimit musliman në shtetet ku jetojnë shqiptarët. Vizita në Memorial u shoqërua me mesazhe paqeje mes shqiptarëve dhe unitet në shërbim të së mirës së përbashkët të mbarë kombit. Historia e lavdishme e Heroit tonë Kombëtar, vijon të ruhet me kaq shumë dashuri edhe nga arbëreshet. Gjatë vizitës që po zhvillojnë në Shqipëri, ndalesë e tyre ishte sot dhe qyteti jonë i Besëlidhjes.



At Sirdani vjen në Lezhë në Ditën Ndërkombëtare të Librit

Me date 23 prill, ne Ditën Nderkombetare te Librit, Biblioteka "Gjergj Fishta" dhe Biblioteka Franceskane, prezantuan biografine e historianit Marin Sirdani, permes kumtesave te dy autoreve tw kwtij botimi At Mirash Marinaj dhe At Victor Demaj e tw studiueseve Aljula Jubani dhe Evalda Paci, tw cilat hodhwn dritw mbi personalitetin dhe kontributet e tij. Me njw jetw tw vwshtirw, por tw devotshme fetare, At Sirdani wshtw ndwr autorwt madhorw franceskanë, i përkushtuar në gjurmimin e trashëgimisë shqiptare, për të dëshmuar vetitë etnike të shqiptarit. Ai ka mbledhur legjenda dhe gojwdhana, veçmas mbi Heroin tonë Kombëtar Skënderbeu, për të dëshmuar, nga pozitat e studiuesit të mirëfilltë, historinë e Shqipërisë. Deri në persekutimin komunist, punimet e tij janë publikuar denjësisht në revistat Hylli i Dritës dhe Leka, ndërsa ky botim biografik sjell gjurmët e "këtij kolosi të studimeve historike dhe një nga analistët më të mëdhenj të Historisë së Shqipërisë" - çmon në parathënien e librit Prof. Dr. Nertila Ljarja.

At Aurel Gjerka, Ministër Provincial, pedagoget Jubani dhe Paci, publicisti e botuesi Frano Kulli, Drejtori i Kulturës në Bashkinë Lezhë, z. Ardian Laci, shkrimtari Ernest Marku, familjari i At Sirdanit, Gjovalin Lucaj, etj, duke e pasuruar prezantimin me detaje njerëzore dhe dëshmi nga puna e At Sirdanit, u ndalën në nevojën e fortë që shoqëria jonë ka për të njohur emrat e denjë të kulturws dhe studiuesve shqiptarë, si rruga e vetme për të ndërtuar kujtesë dhe të ardhme. Në këtë frymë, pjesë e aktivitetit ishin dhe të rinj maturantë nga shkolla Rogacionistët, bashkë me shumë personalitete të tjera kulturëdashëse të jetës së qytetit të Lezhës.



Gëzuar Pashkët!



Bashkia Lezhë,
Lagjia Skënderbeg,
Sheshi "Gjergj Kastrioti",
4501, Lezhë,
info@lezha.gov.al
www.lezha.gov.al